

Albaniankielinen kavatusvihkonen vanhemmille

Fletushkë në gjuhen shqipe

Roli i prindërve në edukimin e femijëve



Väestöliitto

PËRBAJTJA

HYRJE

| | |
|---|----|
| 1. FËMIJET JANË PJSË E FAMILJES DHE SHOQËRISË | 4 |
| 2. NË EMIGRIM NDESHEMI NE SITUATA TË REJA | 8 |
| 3. NANA DHE BABA: MENDIME PËR EDUKIMIN E FËMISË | 12 |
| 4. INTEGRIMI NE SHOQËRIN E RE | 16 |
| 5. SI TE NDIHMOJMË FËMISË NE VIJIMIN E SHKOLLËS | 18 |
| 6. IDENTIFIKO PROBLEMET-KËRKO KËSHILLA DHE NDIHMË | 24 |
| 7. I RIU ADOLESHENT BËHET I RRRITUR | 26 |
| 8. EDUKIMI I FËMIJËVE KËRKON PËRKUSHTIM | 28 |
| 9. KU MUNDË TË KËRKOHET NDIHMË | 30 |



HYRJJE

Ne te gjitha shoqerite dhe kulturat prindërit ju dëshirojne fëmijeve ardhmeri te mirë.Prindërit duan që fëmijet ti rrisin dhe edukojne ne njerëz te denjë e te dobishëm për familjen,farefisnin dhe shoqërin.Ne llojlojshmërin kulturore ne botë ekzistojn edhe mendime e bindje tjera cfarë është vlerë..Gjithashtu si fëmija e edukohet, munde te ketë dallime sipas vendit dhe kulturës.

Si emigrant ndesheni me shoqeri dhe kulture te re,si dhe me kulturen edukimit.Me emigrim mund të ndryshojnë shumë gjëra,një prej tyre është edhe edukimi i fëmijeve.Modelet e me parëshme mbi edukimin qe i keni njohur ndoshta nuk ju pershtaten ne vendin e ri.

Ne këtë fletushke bëhet fjalë per edukimin e fëmijeve.Si ndikikon migrimi ne familje . Rolin dhe detyrat prindore.Gjithashtu tema te kesaj fletushke janë edhe mbështetja e fëmijeve në vijimin e shkollimit,ruajtja dhe pasurimi i gjuhës amtare etj.



1. FËMIJA SI PJESË E FAMILJES DHE SHOQËRISË

Fëmisë i duhet bindje dhe ndikim

Foshnja nuk rritet vetem me ushqim. Fëmija duhet të jet i rrethuar me njerzit te cilët e udhëzojnë dhe këshillojnë. Të rriturit duhet të jen shembull për fëmin. Ju si nanë apo babë, jeni te rëndesishëm për zhvillimin dhe rritjen e fëmisë. Është në të mirë të fëmisë të mësoj gjëra të reja. Gjithashtu është me rëndësi të ju besoj prindërve dhe ta ndjen kujdesin që e merr.

Fëmija është kureshtar dhe ka dëshirë për të nxën

Të gjithë fëmijët jan kureshtarë dhe kanë dëshirë me nxën gjëra te reja. Foshnja percjell levizjet e të rriturve dhe meson nga ato, si lëvizjen e buzeve ,shiqimet ,levizjen e duarve. Fëmijë duhet ta leni ti provon gjërat e reja qe i meson..Fëmija meson duke i percjell te tjeret cfarë bëjn, gjithashtu mesohet të ndëgjon kur flet me të.

Kur foshnja rritet mëson edhe më tepër. Mund ta mesoni për shumë gjëra duke e shetitur dhe spjeguar per vendet qe shihni, duke i lexuar libra etj. Kështu mëson gjëra me dobi ku fëmisë i zhvillohet mënyra e të menduarit, gjithashtu i zhvillohet memoria dhe fjalori i pasurohet. Të gjitha këto mësimë janë ne dobi të fëmisë sidomos kur të filloj shkolla.

Për fëmijë e vogël është me rëndësi loja ku mund ti provon kreativitetin e tij. Loja e zhvillon fëmijë në mënyra të ndryshme. Përkujdesu që fëmija të këtë lodra dhe kohë për lojë .



Kur fëmija dëshiron të luaj me të tjerët është mirë të pyes "A ban të luaj me ju"

Për edukimin e fëmijës lodërat e shrenjëta nuk janë edhe më të mirat. Lodrat e mira janë ato që shfrytëzohen në shumë mënyra. Si për shembull lodrat e mira ofrojnë mundësi të ndryshme për ndarjen e roleve si dhe zhvillimin e imagjinatën. Kësi lloj lodrash janë lapsat me ngjyra, plastelinët dhe katrorët për ndërtim. Në shumë studime është dëshmuar se fëmija që ia del në krye ose përshtatet me fëmijët tjerë edhe në moshën e rritur do të jet i përshtatshëm. Kujdesi për tjetrin dhe rregullat e përbashkëta fëmija i mëson duke lozur së bashku me fëmijët tjerë. Gjithashtu është edhe që edhe fëmijët më të vegjël të familjes të mësojnë që ta presin rradhën e tyre.

SI MUND TI NDIHMOJ FËMISË TË BASHKPUNOJ ME FEMIJËT TJERË

- dergo fëmin ne vende ku ka fëmijë tjerë
- jepi kohe ,vend dhe mundesi të luaj
- meso fëmin të pret në radhëdhe ti shkembej lodrat me të tjerët
- foli nëse fëmija sillet në menyrë agresive apo i ngacmon të tjerët
- meso fëmin te shpreh me fjalë idhnimin dhe dëshprimin



Edukimi është të qenurit në bashkësi

Fëmija të cilit prindërit i kushtojnë kohë, kujdes dhe udhëzime të mirëfillta do të jetë gëzim dhe mburrje për prindërit dhe farefisin. Lidhja dhe afërsia e fëmijës me prindërit e forcojnë mirëqenjen e tij. Kjo është edhe parakushtë për edukim të baraspeshuar. Fëmija i cili ka raport të afërtë bile me një të rritur, është argument i mirë jo vetëm për suksesin në shkollë por edhe për gjithë jetën. Fëmija do të ketë ardhmëri të mirë.

CFARË MUND TË BËJ ME FËMIJËN TIM

- shiqoj dhe lexoj libra e pastaj i bashkëbisedoj ato
- i mësoj vjersha në gjuhën amtare, tregime, këngë dhe përralla
- i tregoj për farefisin për vendlindjen dhe për gjërat që kanë ndodhur në të kaluarën
- bisedoj për ndodhitë e ditës hobit dhe për shokët e fëmijës
- e qoj fëmijën që të vizitoj vende të ndryshme: në muze, qytet, fshat, kopsht zologjik, bibliotekë e tjera tjera
- punët shtëpiake, p. sh. përgatitni ushqim, gatvani ose edhe pastroni së bashku
- ushtroj talentin e dorës, p. sh. mbajtjen e lapsit në dorë dhe përdorimin e gërsërëve

*Gjithashtu bisedo me fëmijën për të gjitha çfarë bëni dhe çfarë po shihni,
Kështu fëmija vazhdimisht mëson gjëra dhe fjalë të reja*



Nuk është e lehtë të organizohet koha e lirë me fëmijën.

Mirëpo çdo ditë mundeni të jeni së bashku. Merrni fëmijën me veten kryerjen e detyrave e përditshmërisë si p.sh përgatitja e ushqimit, rregullimi i tavolinës, bërjen e ushqimit në shitore. Në të njëjtën kohë vazhdimisht bësdod me te se si ka kaluar gjatë ditës në qerdhe. Ndëgjojeni me vemendje dhe në të njëjtën kohë i parashtroni pyetje të ndryshme.

Dëshmo që je e interesuar për jetën dhe mendimet e fëmijës.. Kështu krijon besueshmërin dhe mirëkuptimin e ndërsjelltë.

Nese femija nuk ka dicka interesante te bej ,merzitet lehtë , dhe fillon të sillet në mënyrë të papërshtatshme. Kerkesat e medha ndaj fëmise munden ta friksojne ate.

Fëmijet janë perkah natyra dhe shkathetsit te ndryshem dhe sillen secili sipas mënyrës vet. Nuk duhet te bëni krahasime me ze në mes të fëmijeve,por duhet ti vlersoni cfare janë. Duke e lavdru femijen ,do ti ti jepni vullnet edhe më shumë te bej sjellje të mira.



2. MIGRIMI SJELLË SHUMË GJËRA TË REJA

Ambienti i ri edukues

Ambienti ku jeni edukuar është tjetër nga ambienti ku edukohen fëmijët tuaj. Në vendlindje ke pasur farefisin, antarët e familjes dhe fqinjët, të cilët të kanë ndihmuar në kujdesin dhe edukimin e fëmijëve. Fëmija ka pas mundësi të mirë të merr shembuj dhe udhëzime të mira nga të rriturit e ndryshëm. Modeli i nënës dhe i babait është përcjellë nga brezi në brezë. Si në shtëpi ashtu edhe në fqinjësi ka egzistuar një shqyrtim i njejtë i edukimit të fëmijëve. Si emigrantë situata jote prej edukatorit ka ndryshuar rrënjësisht. Për vet faktin se ndihmesat e farefisit dhe fqinjëve janë të pakësusara, dhe tani përgjegjësia jote si prind është më e madhe në krahasim me kohën e më hershme.

Tani edukimi i fëmijëve do të duket shumë më i rëndë e sidomos nëse keni shumë fëmijë. Përveq kësaj mënyra e mëparshme e edukimit dë të ndeshet me mënyrën finlandeze të edukimit të fëmijëve.

- **Mendo se cilat ishin veqoritë e "nënës së mirë" dhe babait të mirë" në vendlidjen tënde**
- **Cfarë janë kërkesat e "nënës së mirë" dhe "babait të mirë" tani kur banon në Finlandë**
- **Cilat janë dallimet dhe cilat janë gjërat e njehta në edukim**
- **Cilat janë sfidat e reja si prind me të cilat ndeshesh në Finlandë.**



Në cdo kulturë ndeshesh me anët e mira dhe anët e këqija të edukimit. Si emigrantë e ke mundësinë që të krijosh një formë të re të edukimit duke ruajtur nga kultura jote anët e mira të edukimit dhe duke huazuar të mirat nga kultura finlandeze.

Ndikimet e migrimit në familjen tuaj

Adaptimi në vendin e ri dhe mësimi i gjuhës zakonishtë janë ekperiencë e rëndë për tër familjen. Shumë gjëra ndërrojnë shpejtë dhe rrënjësishtë dhe për tu adaptuar në vendin e ri shkojnë vite të tëra. Shumica nga emigrantët përjetojnë stres gjatë kësaj periudhe.

Gjithashtu migrimi cdoherë ndikon në familje. Rrolet e burrit dhe gruas ndryshojnë rrënjësishtë dhe nuk janë ato të mëparshmet. E njëjta gjë ndodhë edhe në raportin ndërmjetë prindërve dhe fëmijëve. Fëmijët nëpërmjetë qerdhes dhe shkollës shumë më shpejtë e përqafojnë kulturën finlandeze.

Dallimi në mes kulturës etnike dhe kulturës finlandeze mund të krijojnë keqkuptime në shtëpi. Fëmijët zakonishtë e mësojnë edhe gjuhën më shpejtë se prindërit. Prindërit mund të kujtojnë se nga ndikimi i kulturës finlandeze do ti humbasin fëmijët e tyre.

Nëse fëmijët detyrohen të interpretojnë finlandishtë ose suedishtë për prindërit e tyre, rolet në familje do të ndryshojnë rrënjësishtë. Prindërit në ato raste do të mendojnë se do ta humbasin vlerën e rolit të prindit. Gjithashtu edhe fëmijët poqëse shumë shpesh janë në rrethana kur do të marrin përgjegjësinë e të rriturëve atëherë një mënyrë apo tjetrën e humbasin fëmijërinë e tyre.

Gjithsesi prindërit më së miri mund ta ruajnë kontrollin dhe rolin e prindërve duke e studjuar gjuhën dhe duke u integruar në sistemin shkollor të shoqërisë finlandeze, me punë apo hobi të ndryshëm. Kështuqë ata gradualishtë do ta kuptojnë shoqërinë dhe kulturën e re, ashtuqë atëherë do të dijnë që ti drejtojnë fëmijët më së miri në këtë mjedis të ri.


Gjithashtu edhe rolet e bashkëshortëve mund të ndryshojnë si pasojë e migrimit. Në shoqërinë finlandeze vazhdimishtë potencohet barazia gjinore. Mundësia e grave emigrante që të studjoj, të punoj dhe të kete të hollat e saj gjë që mund ta ndryshoj rrolin ndërmjet burrit dhe gruas. Gjithashtu meshkujtë mund të kujtojnë që për shkak të emigrimit ata po e humbasin pozitën dhe respektin sikur në familje ashtu edhe në shoqëri. Posaqërishtë poqëse punësimi do të jet i vështirë, në ato raste burri e ka më vështirë që të bëj dicka të dobishme për ta kaluar kohë më mirë. Në të njëjtën kohë kur burrat provojnë ta gjejnë rolin e ri në vendin e ri, roli i gruas si nënë dhe si edukatore është i vështirë dhe obligative.

Babai në rolin e ri e edukatorit

Sikur nënat ashtu edhe babatë kanë ambicie të mëdha karshi fëmijëve. Ata presin që fëmijët të shkojnë në shkollë dhe të edukohen si u ka hije të rinjëve, të cilët do të punësohen dhe do ti ndihmojnë farefisit dhe prindërve të tyre. Që të arrihet ky objektivi fëmijës modoemos i nevojitet edhe prezenca dhe ndihmesa e babait. Në Finlandë përveq nënave që kujdesen për fëmijët e vegjël që janë në shtëpi, po të njejtën mundësi e kanë edhe babatë të cilat punojnë. Drejtohuni në zyren e KELA-së dhe pyetni për ndihmesat sikur meditet për nëna, baba, ose për prindër. Për shkak të migrimit atherë babatë duhet ti gjejnë detyrat dhe rrolet e reja si edukator të fëmijëve. Pjesëmarrja sa më aktive e babasë në punët e shtëpisë si dhe në edukimin e fëmijëve i jep ndihmesë të madhe si fëmijëve ashtu edhe familjes. Babai sa më shumë të jet prezent në jetën dhe edukimine fëmijëve, fëmija do ti ket mundësitë shumë më të mëdhaja që të mësoj gjëra të mira dhe të drejta, do të jet më i mirë në shkollë si dhe do të qëndroj largë shoqërisë se keqe.

Një punëtor emigrant i qerdhesë ka thënë: E kam vërejtë se fëmijët të cilët babatë i marrin nga qerdhja herë pas here ata fëmijë janë më të sjellshëm dhe më të baraspeshuar se sa fëmijët për të cilët vetëm nëna merr pjesë në edukimin e tyre. Këto nëna janë të lodhura dhe nuk kanë durim të mjaftueshëm për fëmijët. E kjo vërehet edhe te këta fëmijët.

Pjesëmarrja e babave në punët e shtëpisë si dhe në edukimin e fëmijëve është me rëndësi të veçantë për mirëqenjen dhe tërësinë e familjes. Gratë pyesin se për çfarë na nevojiten burrat, të cilët nuk shihen në shtëpi. Nëse babatë janë jashtë shtëpisë, ata për këtë mund ta humbasin respektin e duhur nga familja. Pjesëmarrja e burrit në shtëpi lehtëson punët për gruan ngase ajo nuk duhet ti kryej të gjitha punët por një pjesë të atyre punëve do ti kryej burri.



NË CFARË MËNYRE BABAI MERR PJESË NË EDUKIM

- e kalon kohën me fëmijën duke luajtur, duke i mësuar gjëra dhe tregime të ndryshme
- i ndihmon në kryerjen e detyrave dhe e mbikqyrë vijimin e mësimit
- i përcjellë dhe merr pjesë në hobit e ndryshëm të fëmijës
- i ndanë punë barabartë me gruan
- i jep mundësi që edhe gruaja ta ketë kohë për vetveten



3. NËNAVE DHE BABAVE: SYGJERIME PËR EDUKIMIN E FËMIJËVE

Përkrah, skjaro dhe argumento

Është mirë që fëmijës ti kushtoni vëmendje dhe ta përkrahni atëherë kur ai sillet mirë. Duhet gjithsesi që fëmijës ti skjaroni dhe ti argumentoni se për çfarë arsye një sjellje e pahijshme nuk është e drejtë dhe e mirë. Shpeshherë skjarimi dhe butësia janë shumë më të mirë se urdhërat.

Për shembull mund ti thuash fëmijës:

"Me rëndësi është që të shkosh me kohë me fjetur, përndryshe në mëngjes do të jesh i lodhur dhe do ta kesh vështirë të shkosh në shkollë."

Apo:

"Këtë program televiziv nuk ban ta shiqosh ngase nuk është për fëmijë. Fëmijët shohin ëndrra të këqija nëse shiqojnë programe të papërshtatshme."

Apo:

"Në shtëpi kthehu më së voni në orën 9 të mbrëmjes, se për fëmijë nuk është sigurtë nëse ata rrinë von jashtë shtëpisë, gjithashtu duhesh të fleshë më herët se nesër është ditë shkolle."

Nëse fëmijëve ua argumenton mirë gjërat, ata i kuptojnë gjërat më mirë gjithashtu fillojnë të mendojnë edhe vet se cka është më mirë për ta.

Fëmijëve të vegjël u përsëriten më shpesh këto rregulla. E kur fëmija rritet ai mësohet që ti respektoj rregullat edhe më mirë. Gradualisht fitohet besimi në fëmijën dhe gjithashtu atij i jep edhe më shumë përgjegjësi dhe në të njëjtën mënyrë ai do të sillet edhe jashtë shtëpisë. Fëmija më së shumti mëson sipas sjellejeve tua dhe të tjerëve. Shembujtë nga të afërmit janë për fëmijën me rëndësi të veçantë.

Kur fëmija është hidhëruar është mirë që të pritsi derisa te qetësohet e pastaj në mënyrë të qetë bisedoni me te. Fëmija mund edhe të denohet nëse vazhdimisht sjellet keq. Në Finlandë me ligj është i ndaluar ndëshkimi fizik i fëmijës. Në vend të kësaj ndëshkimi mund të jetë për shembull mosdhënja e të hollave javore, karamelave ose dicka çfarë ka fëmija për merak, gjëra të cilat i merr vazhdimisht ose është mësuar që ti merr. Fëmija vendoset në dhomen tjetër që të mendoj për gjërat e pahijshme të cilat i ka bërë, si për shembull mu në kohën kur në TV është programi të cilin ai e pëlqen.

Për ndonjë gabim më të madhë atë mund ta futni në arrest shtëpiak për disa netë. Asiqë edhe vet nuk e praktikon dhunën fizike atëherë është mirë që edhe fëmija të mësohet pa atë, gjithashtu mos e mësoni fëmijën që mosmarrëveshjet e tija ti zgjidhë me dhunë për shembull në shkollë.

Në kutinë më poshtë janë udhëzimet e preferuara të ekspertëve finlandez në lidhje me përditshmërinë. Në tabelën vijuese shihen shembujtë për fëmijë mvarësishtë nga mosha se s aorë gjumë ju nevoiten për zhvillimit të truri të tyre si dhe për mirëqenjen e tyre. Shiqimi i tepërt i TV-së dhe loja e tepruar me kompjuter bën që fëmijët të jen të hidhëruar dhe të lodhur.

RREGULLAT SHTËPIJAKE TË PREFERUARA NGA

EKSPERTËT FINLANDEZË:

- Gjatë ditëve të punës fëmijët kthehen në shtëpi më së voni (në kllapa vikendeve)
- 7-10 vj. në ora 19.30 (në ora 20)
- 11-13 vj. në ora 20 (në ora 21)
- 14-16 vj. në ora 21 (në ora 21)
Koha kur fëmijët shkojnë në gjumë
- 10 vj. në ora 21 (në ora 22)
- 11-13 vj. në ora 21.30 (në ora 22.30)
- 14-16 vj. në ora 22 (në ora 23)
- Më së shumti 2 orë në ditë pranë TV-së, videos, si dhe lojërave me kompjuter



Fëmija e përcakton objektivin ndërmjetë shtëpisë dhe shoqërisë

Fëmija së pari edukohet si anëtar i familjes. Më von ai shkonë në qerdhe, pastaj në mësimin parashkollor dhe në shkollë emë pastaj inkuadrohet në rrethin e shoqërisë Dhe kulturës.

Në qerdhe, mësim parashkollor ose në shkollë fëmijët e mësojnë gjuhën finlandeze ose suedeze, mësojnë dituri të reja, dijeni si dhe rregulla të reja të sjelljes.

Edukatorët në të gjitha vendet i përkrahin fëmijët pët ti mësuar këto veqori, për të cilat besohet se në të ardhmën do të ketë interes edhe shoqëria, në të cilën ata jetojnë. Për shembull në punët finlandeze vlerësohet mjaftë vetiniciativa dhe mendimi i pavarur. Për këtë arsye prindërit i përkrahin fëmijët për pavarësinë e tyre, sidomod duke u dhënë hapësirë fëmijëve për vendosur vet në zgjedhje të ndryshme ose i përkrahin gjatë bisedës për dhënë mendimet e tyre. Gjithashtu edhe në shkollat finlandeze provojnë që të forcojnë tek fëmija mendimin e pavarur.

Në disa kultura tjera fëmija e bëjnë më të mvarur prej prindërve ose përdorin prindërit e autoritetin në mënyrë që fëmija të jet vetëm ndëgjues i mirë.

MENDIMI

- A i bëni fëmijës presion që të ketë mendim të pavarur apo të jet i mvarur nga dëshira e tjerëve?
- Cfarë ndikimi pozitiv do të ket mendimi i pavarur tek fëmija?
- Cfarë pengesa do të ketë mendimi i pavarur?
- Sipas mendimit tuaj a është më mirë ta edukoni fëmijën që të jet i pavarur dhe të jetë i ndëgjueshem në disa gjëra

Fëmija dhe i riu jashtë shtëpisë merr modele të ndryshme të sjelljeve, të cilat mund të jen në kundërshtim me shqyrtimet e prindërve. Në shtëpi shpesh ndodhë që të ken moskuptime ndërmjetë prindërve dhe fëmijëve. Prapë se prapë nuk është mirë që fëmija të izolohet nga fëmijët ose nga shoqëria. Më me rëndësi është shoqëria me të lënci fëmija e kalon kohën e lirë. Hobit e mirë, ardhja me kohë në shtëpi dhe kontrolli nga të rriturit e mbajnë largë fëmijën nga shoqëria e keqe.

Kur ndodhin keqkuptime në mes prindërve dhe fëmijëve, me rëndësi të veçantë është që të bisedohet së bashku për të gjitha mendimet dhe dëshirat e dy palëve. Gjithashtu është me rëndësi që të dy palët të jen të gatshëm për marrëveshje reciproke. Në rastet e keqkuptimeve në mes prindërve dhe fëmijëve faktorët që më së shumti ndihmojnë për të zgjidhë problemin kryesishtë janë marrëdhënja e mirë dhe besueshmëria e duhur.

Nganjëherë ndodhë që shqyrtimet e drejta dhe të gabuara mund të hasin në kontradiktë në mes të prindërve dhe mësuesve të qerdhes dhe të shkollës. Në ato raste fëmijë vie në pozitë të palakmueshme për të mbajtë barapeshën në objektivave dhe shembujve të ndryshëm.

Për këto gjëra është mirë të bisedohet me fëmijën dhe me personelin e qerdhes. Për fëmijën me rëndësi të veçantë është të gjeni kompromisin për këndvështrimet e ndryshmetë jet i dëgjueshëm për disa gjëra tjera?

TEJKALLOJ KEQKUPTIMET – BISEDO DHE JEP INFORMATA TË DUHURA:

- **tregoj personelit të qerdhes dhe shkollës për normat fetare të cilat kanë të bëjnë për ushqimin**
- **trego gjej mirëkuptim me qerdhen dhe me mësuesit e shkollës për rregullat dhe ndalesat të cilat do të ishin të njejta sikur ato të shtëpisë. Për cdo mosmarrëveshje është mirë të bisedoni si për rregullat e mira gjithashtu edhe për ato që janë të kqija**
- **në rast se nuk fletë mirë finlandishtë ose suedishtë, sipas mundësisë pyet që ata ta sigurojnë interpretuesin atherë kur caktohet ndonjë bisedë e rëndësishme me personelin e qerdhes.**
- **tregoj mësuesit se në cfarë kohe mund të kontaktijnë me ty**
- **poqëse je i paknaqur me personelin e qerdhes apo shkollës është mirë që të bisedoni rreth këtyre gjërave.**

Prindërit emigrantë zakonishtë dijnë shumë pak për botën jashtë shtëpisë, dhe për kohën që fëmija i tyre e kalon jashta shtëpisë. Atherë prindi e ka vështirë që ta udhëzoj fëmijën për kohën e lirë dhe vijimin e shkollës. Për këtë arsye është me rëndësi të veçantë poqëse prindërit kanë mundësinë të marrin pjesë dhe ta kuptojnë edhe jetën jashtë shtëpisë së tyre. Për shembull duke marr pjesë në veprimtaritë e shoqatave të ndryshme si dhe bashkëpunimi në mes shtëpisë dhe shkollës ofron mundësi për të kuptuar më mirë botën e fëmijëve. Mësimi i gjuhës finlandeze dhe suedeze si dhe pjesëmarrja në shoqatat e ndryshme u japin mundësi më të mirë të rriturve që të përmirsohet rroli i tyre si edukator.

4. INTEGRIMI

Rëndësia e gjuhës amtare

Gjuha amtare është argumenti më i fuqishëm i identitetit kulturor të fëmijës. Gjithashtu gjuha është argument i fuqishëm i mardhënjës së afërsisë në mes prindit dh efëmijës. Prindërit mund të bëjnë shumë për të ndihmuar fëmijën që ai ta zotëroj gjuhën amtare sa më mirë. Fëmija e mëson gjuhën vetëm duke i folur atij në gjuhën amtare. Gjithashtu me rëndësi të madhe është që fëmijës ti përkushtoheni dhe shprehni kujdes dhe interesim për bisedat e tija.

Është me rëndësi të madhe që prindërit të flasin gjuhën e vet amtare. Ghjuha amtare mësohet edhe më mirë duke lexuar libra së bashku me fëmijën. Nëse nuk dini të lexoni atherë shiqoni libra me fotografi dhe i bisedoni ato sepse në këtë mënyrë fëmija mëson fjalë të reja në gjuhën amtare. Gjithashtu është mirë që me fëmijën të shiqoni TV dhe të bisedoni rreth asaj që shihni në TV, se edhe atherë fëmija mëson gjëra të reja. Së bashku me fëmijën duke vizituar vende të ndryshme, bibliotekë, muze, qytet dhe në natyrë atherë fëmijës i rritet dijenia për botën në të lënci ai jeton. Duke biseduar me fëmijën i ndihmon atij që ta pasuroj fjalorin.

Studimet tregojnë që gjuha e re mësohet shumë më lehtë atherë kur gjuha amtare zotërohet mirë. Fjalori i pasur në gjuhën amtare i ndihmon fëmijës që ta mësoj mirë edhe finlandishten ose suedishten ekjo është garancë e mirë që fëmija të ketë sukses në shkollë. Prindërit nuk duhet të brengosen nëse fëmija i përzinë gjuhën amtare finlandishten ose suedishtën. Atherë kur prindërit i ndihmojnë fëmijës që ta zhvilloj ehde më tej gjuhën amtare, dy gjuhët nuk do të përzihen më, edhe poqëse fëmija i përdorë ato në të njejtën kohë.



Integrimi i prindërve

Shumica e emigrantëve ëndërron për tu kthyer në vendlindje. Nganjëherë malli për rrethin e vjetër dhe për njerëzit e afërmë është shumë i fuqishëm. Gjithahstu edhe vështërsia në adaptim në vendin e ri fuqishëm e shtojnë dëshirën për kthim.

Edhe pse janë në vendin e ri prindërit me vite të tëra ëndërrojnë për kthimin në vendlindje. Në të njejtën kohë kur fëmijët e tyre jetojnë në kohën më të rëndësishme të edukimit dhe ardhmërisë së tyre. Fëmijët kanë nevojë për prindërit të cilët e mësojnë gjuhën dhe ambientohen në shoqërinë e re. Ata kanë nevojë për prindër të cilët dijnë të lexojnë, ti udhëzojnë dhe ti këshillojnë ata në ambientin e ri, ku fëmijët e e jetojnë fëmijërinë e tyre. Për këtë arsye integrimi i prindërve është me rëndësi të veçantë për fëmijët. Fëmija jeton "tani dhe këtu".

Fëmijët duhet të kuptojnë që vijimi i shkollës në këtë shoqëri është me rëndësi pavarësisht nga ajo se familja ndoshta një ditë do të kthehet në vendlindje. Kur fëmijët ndihmohen në edukim dhe shkollim, ata fëmijë do të jen të fuqishëm, të përshtatshëm dhe të dijsëm dhe të cilët do t'ia dalin mbanë në cdo kohë. Nëse dikur familja kthehet mbrapa në vendlindje atëherë është shumë mirë që fëmijët kanë marrë shkollim të duhur dhe do të jen të dobishëm edhe në vendlindje. Kjo do të lehtësojë riatdhetizimin në vendlindje.



5. SI TË NDIHMOHET FËMIJA NË SHKOLLIM

Për çfarë shkollimi është i rëndësishëm?

Kudo në botën e tanishme nga njerëzit kërkohet dijeni dhe zotësi më të madhe. Përpara në Finlandë shumë nga profesionet janë mësuar duke i parë dhe duke i përcjellë profesionalistët. Ndërsa tani shkollimi në shkollat profesionale është rruga e vetme për të gjet punë.

Shumica nga prindërit e kuptojnë këtë dhe dëshirojnë që fëmijët e tyre të shkollohen dhe të ken sukses në këtë drejtim. Mundësia e fëmijëve për suksesin në shkollë nuk është gjenetike por ndikimi më i madhë vë nga edukimi mvarësishtë nga ajo se si fëmijët ambientohen në shkollë. Prindërit kanë ndikim edhe tek fëmijët e vegjël se në çfarë mënyre në të ardhmën këta fëmijë do përshtaten në shkollë. Fëmijët mund të ndikojnë në suksesin e fëmijës në shkollë qysh herët duke e mësuar atij koncentrimin, gjuhën amtare sa më mirë dhe duke e mësuar fëmijën që të jet i përshtatshëm me fëmijët tjerë.



Qerdhja dhe mësimi parashkollor e pregatisin fëmijën për shkollë

Prindërit emigrantë dhe zyrtarët mganjëherë nxitojnë shumë që fëmija të mësoj sa më shpejtë finlandishtë ose suedishtë. Ata dëshirojnë që sa më herët fëmijën ta qojnë në qerdhe për të mësuar gjuhën. Zakonishtë për fëmijët nën moshën trevjeqare shtëpia është vendi më i mirë për këta fëmijë. Në shtëpi fëmija krijon raportin me prindërit dhe e mëson gjuhën amtare. Kur gjërat themelore dhe gjuha amtare janë mësuar atherë ai fëmijë do të mësoj dhe do të jet i përshtshëm edhe në ambientin ku flitet gjuha tjetër.

Për fëmijët e vegjël është mirë që ata fillimishtë fillojnë të mësohen me grupin e fëmijëve dhe kontaktin me gjuhën e re. Kjo mund të behet edhe në qerdhet e hapura ose në grupet e fëmijëve. Në këto vende mësohen edhe gjëra të tjera të cilat do ti nevoiten fëmijës në shkollë, për shembull mbajtja e lapsit ose prerja me gërshtë, koncentrimi, përshtatja me tjerët socialiteti e tjera e tjera. Poqëse fëmija që fillon shkollën porse finlandishtja ose suedishtja nuk janë mësuar mirë atherë fëmija ka mundësi ta filloj shkollën duke e mësuar gjuhën në mësimin parapregatitor.



Mësimi parapregatitor fëmijës i organizojnë mësim shtesë nga finlandishtja ose nga suedishtja. Gjatë kohës së mësimin parapregatitor por edhe më pastaj fëmija transferohet në grupet e mësimin fillor. Mësimi parapregatitor ndihmon fëmijën që fillimi i shkollës të jet sa më i mbarë, dhe pas kësaj fëmija vazhdon në klasët e shkollës fillore. Për mësimin parapregatitor mund të pyetni në dikasterin për arsim në komunën ku banoni.

Si i ndihmohet fëmijës në përditshmërinë e vijimit të mësimin

Fëmija kur e fillon shkollën, prindërit mund ta ndihmijnë në mënyra të ndryshme. Së pari është e rëndësishme që fëmijëve sikur vajzave ashtu edhe djemve u tregohet se shkollimi është i rëndësishëm për ardhmërinë e tyre. Gjithahstu prindërit cdo herë duhet ta shprehin interesimin e tyre për shkollimin.

Bashkëpunimi shtëpi shkollë është i rëndësishëm së veçantë. Kur fëmija e fillon shkollën apo kur mësuesi ndërrohet është mirë që prindërit ta caktojnë kohën që të bisedojnë me mësuesin. Në atë bisedë ipen të dhëna të për shkollimin e mëhershëm të fëmijës, për kërkesat e veqanta të tij si dhe për vështirësitë. Poqëse në familje egziston diq që ndikon në shkollimin dhe koncentrimin e tij atherë të gjitha ato duhet të tregohen gjatë asaj bisede (për shembull sëmundje, brengë apo raporte të kqija në familje). Në këtë mënyrë mësuesi do të ket të dhëna më të hollësishme sa i përket mësimin ashtuqë sipas nevojës do të ket dijeni si duhet ndihmuar ai fëmijë.

SI TË NDIHMOHET FËMIJA GJATË SHKOLLIMIT

- rregulloja fëmijës tavolinës e punës të përshtatshme që ti kryej detyrat e shtëpisë
- pyet cdo ditë cka keni mësuar në shkollë si dhe cfarë ka ndodhë gjatë pushimeve
- kontrollo a janë kryer detyrat; kërko nga fëmija të tregoj se cka ka mësuar
- nëse nuk mundesh ta ndihmosh fëmijën me detyrat, kërko ndihmëga prindërit tjerë krijto rrethin që të ndihmon për ti zgjidhë këto detyra
- kontakto vazhdimishtë me mësuesin gjithahstu merr pjesë në mbledhjet e prindërve

Gjithahstu takimet e tilla janë të rëndësishme edhe gjatë vitit shkollor, për faktin që prindërit të kenë mundësinë të marrin informata të duhura për vijimin e mësimit. Në këtë mënyrë ata mund të ndikojnë në vendimet e ndryshme që kanë të bëjnë me fëmijën e tyre. Prindërit kanë të drejtë për interpretin gjatë mbledhjeve të prindërve si dhe gjatë takimeve individuale me mësuesin. Nformimet e ndërsjella janë tejet të rëndësishme. Prindërit mund ta sugjerojnë mësuesin që ai ta caktojë interpretin në vendngjarje. Interpretët sikurse edhe mësuesit dh e zyrtarët tjerë janë nën betimin e sekretit profesional që ka të bëj me qështjet e fëmijës dhe të prindërve.

E drejta e fëmijëve është që të kenë mësimit e vet fetar në kuadër të shkollës, poqëse janë së paku tre fëmijë nga grupi i njejtë mësmor. Prindërit duhet ta dijnë që për një organizim të till ata duhet të aplikojnë në shkollë.

Në shumë shkolla organizohet edhe mësimi në gjuhën amtare për fëmijët emigrantë. Prindërit për këtë duhet të informohen në shkollë për mundësitë e organizimit të mësimit në gjuhën amtare. Prindërit gjithahstu duhet ta përkrahin fëmijëne tyre që të mësojnë gjuhën amtare në kuadër të shkollës, ngaqë vetëm me anën e gjuhës amtare ata do të kenë mundësinë e kontaktit me prindërit, farefisin, vendlindjen dhe me kulturën. Njohja e gjuhës amtare ndihmon që gjuha e re të mësohet më lehtë.



Fëmija kur ka nevojë për ndihmesë speciale në shkollë?

Poqëse fëmija ka vështirësi në mësim apo prindërve u duket se fëmija i tyre ka nevojë për ndihmesë shtesë për shembull nga gjuha finlandeze ose në ndonjë lëndë tjetër, është e mundur që shkolla të ketë mundësi për organizim të mësimit shtesë. Për mësimin shtesë duhet të bisedoni me kujdestarin e klasës. Egziston mundësia që në shkollë të ketë ndonjë ndihmës i vijimit të mësimit që fletë gjuhën amtare të fëmijës, e ky mund ti ndihmon fëmijës rreth mësimit.

Poqëse fëmija ka nevojë për ndihmë në kohë të gjatë, atherë prindërit aplikojnë për të drejtën e mësimit special. Nganjëherë edhe prindërve u ofrojnë këtë lloj ndihme speciale për fëmijën e tyre, në rast se kjo është vërejtje qysh në qerdhe ose në mësimin parashkollor. Fëmija mund të ketë vështirësi në mësim, vështirësi emocionale apo edhe zhvillimi i tij është më i vonshëm e mu për këtë për mësim duhen kërkesa speciale. Mësimi special ka për qëllim tu garantoj fëmijëve mundësinë që ata të mësojnë me ndihmesën më të përshtatshme për te. Mësimi special ka për qëllim tu ofrojë fëmijëve më shumë ndihmesë në mësim. Vendimi për mësimin special bëhet në marrëveshje në mes të prindërve dhe personelit të shkollës.

Mësimi special mund të mbahet në kuadër të klasës së zakonshme, në klasën ose në shkollën speciale. Klasa speciale numerikisht është e vogël, dhe për këtë fëmija ka mundësi më të madhe për përkushtimin adekuat nga mësuesi. Shpeshë nxënësi që ka nevojë për mësim special vijon mësimin në klasën e zakonshme mirëpo për te ofrohet ndihmesa adekuate. Për cdo nxënësi të mësimit special bëhet planprogrami individual (HOJKS). Vendimi për mësimin special mund edhe të anulohet atherë kur fëmija nuk ka më nevojë për ndihmë speciale.

Në cdo shkollë egziston grupi punues për nxënësit, qëllimi i të cilit grup është ta avansoj mirëqenjen dhe mundësinë e studimit në shkollë. Grupi punues për nxënësit i cili përbëhet nga kuratori i shkollës (puntori social), psikologu, drejtori, motra medicinale dhe mësuesit bashkëbisedojnë për organizimin e mësimit për nxënësit të cilët kanë nevojë për ndihmesën speciale.

Prindërit e kanë mundësinë që të marrin pjesë në këto bisedime, ku shqyrtohen gjërat që i përkasin fëmijës së tyre. Prindërit mund ta shprehin këndvështrimin e tyre dhe kështu marrin pjesë aktive atherë kur mirren vendime për fëmijën e tyre. Së bashku me grupin bëhet planprogrami për ndihmesën gjegjëse. Prindërit e kanë mundësinë që të ndikojnë në këto vendime të shkollës. Nëse diskutohet për ndërrimin e klasës atherë prindërit paraparakishtë kanë mundësinë që ta shohin klasën gjegjëse dhe të njoftohen me rregullimin mësimor si dhe me planprogramin e bërë për fëmijën e tyre.

Në shumë shkolla vepron pedagogi me përkatësi emigrante i cili mbanë bashkëpunimin në mes shkollës dhe shtëpisë.



6. ZBULOJ PROBLEMET – KËRKO KËSHILLA DHE NDIHMË

Fëmija anashkalonë shkollën

Migrimi mund të jet përvojë stresante edhe për fëmijën. Fëmija priton me shkue në shkollë, pasi që ate e ngacmojnë për atë se nuk e zotëron gjuhën aq sa duhet apo për dukjen që mund të jet më ndryshe. Është mirë që prindërit ta dijnë se ngacmimet e fëmijëve në shkollë nuk janë të lejuara.

Poqëse ka ngacmime, atherë prindërit duhet të kërkojnë nga mësuesi, drejtori ose të kontaktojnë edhe me dikasterin e arsimit që ata të intervenojnë për rregullimin e kësaj dukurie. Lëndët e mësimin nganjëherë mund të duken të vështira për fëmijën, e për këtë ai nuk do të ket dëshirë të mahd etë ulet në klasë atherë kur përcjellja e mësimi është e vështërsuar. Në këto raste fëmija ka vështirsi për tu koncentruar do të fillojnë ta shqetësojnë dhe për këtë do të filloj të mungoj nga mësimi. Prindërit në këto raste duhet të kërkojnë nga shkolla mundësinë e organizimit të mësimi shtesë. Nëse kjo mundësi nuk egziston atherë ata vet duhet ta gjejnë ndonjë kusheri i cili do ti ndihmoj fëmijës në kryerjen e detyrave.

Që problemet e shkollës mos të jen të befasishme është mirë cdo herë që prindërit të bisedojnë me fëmijën e tyre për të gjitha përvojat të cilat fëmija i hasë në shkollë. Gjithahstu prindërit duhet të jen në kontakt të vazhdueshëm me mësuesit. Prindërit kanë mundësi që të thërrasin apo të shkojnë drejtë në shkollë, vetëm e vetëm për tu informuar se cdo gjë është në rregullë. Me rëndësi tejet të madhe është edhe pjesëmarrja në mbledhjet e prindërve, ku takoni do ta takojnë mësuesin e fëmijës.

Poqëse prindërit nuk e zotërojnë finlandishten apo suedishten dhe nëse në shkollë është i punësuar dikush që e fletë gjuhën e tyre amtare atherë me ndëmjëtesimime tij mund të dërgojnë porosi në gjuhën e tyre amtare.

Alkoholi, droga dhe kriminaliteti

Nëse i riu fillon të konsumon alkohol, drogë ose mirret me krim atherë arsyet mund të jen nga më të ndryshmet. Traumat e luftës, ndryshimet që ndodhin në familje, përvojat nga faktori i jashtëm, papunësia dhe humbja e shpresës mund të shkaktojnë që i riu do të ikë nga realiteti dhe futet në alkohol ose në drogë. I riu shpeshë herë kujton se për shkak të dallimeve kulturore nuk është më pjesë e familjes, mirëpo edhe jashtë shtëpisë nuk është i pranuar. Bandat e të rinjëve i duken vendi më i mirë për të kaluar kohën dhe se ata i kompenzojnë raportet njerëzore të cilat i mungojnë atij. Sidomos nëse kanë migruar në shtetin e ri në kohën e pubertetit posaqërishtë atherë do të kenë presion si nga shkolla ashtu edhe nga i zhvillimi i tyre. Në rastin e tyre grumbullohen kërkesa të shumta në kohëzgjatje të shkurtë: mësimi i gjuhës së re, lëndët e vështira në klasët e larta të shkollës fillore dhe kalimi shkollën e mesme, ndryshimet trupore fizike dhe psikike të pubertetit, këndvështrimet e ndryshme të prindërve dhe të

shokëve. Poqëse i riu nuk ka ndonjë model pozitiv nga i cili do të mësoj, atherë i riu do të ket vështirësi të besojë në ardhmërinë e mirë.

Në këtë moshë kuptimi dhe ndihmesa nga ana e prindërve ndihmon fëmijën që të përparoj. Gjithahstu edhe rregullat e karta të përcaktuara nga prindërit si për shembull koha e ardhjes në shtëpi, përkrahja për tu marrë me hobi të ndryshme e ndihmojnë fëmijën të qëndroj largë shoqërisë së keqe. Edhe poqëse paraqiten probleme me alkoholin, drogën apo krimin prindërit nuk kanë nevojë ta gjykojnë veten apo marrohen nga këto qështje. Me rëndësi të veçantë është të shqyrtohen haptas këto fenomene, sepse vetëm në këtë mënyrë do të ofrohet ndihma si për fëmijën ashtu edhe për familjen.

Dhuna në familje

Në cdo familje ka kundërshtime. Mirëpo këto nuk zgjidhen me dhunë. Është e udhës që të bisedojnë të dy palët dhe së bashku ta gjejnë zgjidhjen. Ushtrimi i dhunës është i daluar me ligj.

Nëse hidhërimi dhe tërbimi është i madhë sa që prindi mendon ta rrahë fëmijën, më e udhës është të dilet jashtë ose në dhomën tjetër derisa nuk qetësohet gjendja. Edhtë mirë ti ipni veten kohë që të mendoni dhe të gjeni zgjidhje tjetër.

Prindërit mund të përjetojnë shok, nga e dhëna se nga ushtrimi i dhunës egziston që fëmijën tua marrin për kujdes. Prindërit nuk mendojnë të keqen nëse dëshirojnë me dhunë ta diciplinojnë fëmijën, poe ata mendojnë ta edukojnë për së mbari. Mirëpo ekspertët e edukimin kanë dëshmuar që dhuna fizike e dëmton zhvillimin shpirtëror të fëmijës dhe mu për këtë është e ndaluar. Prindërit duhet ta ken të kjiartë që personeli i qerdhes dhe i shkollës është i obliguar të lajmëron zyrtarët gjegjës poqëse vërejnë tek fëmija shenja të dhunës.

Gjithashtu ndryshimet e shumta në mardhënjen në mes burrit dhe gruas edhe stresi i shkaktuar si pasojë e migrimit, ose për shembull zvogëlimi i autoritetit të burrit në familjen mund të shkaktoj dhunë në mes burrit dhe gruas. Në këto raste është mirë të kërkohet ndihmë dhe mbrojtje qysh prej fillimit. Edhe në këto raste zgjidhja kërkohet me bisedë.



7. NË PUBERTET I RIU BËHET I RRIUR

Zhvillimi nga i riu në të rritur kërkon kohë

Në pubertetet fëmija bëhet i rritur. Me pubertetet nënkuptohet moshën nga 10 – 18 vjeçë. Në këtë periudhë i riu zhvillohet fizikisht dhe psikikisht. Te cdo i rritur nuk ndodhe menjehere, por se cili zhvillohet me ritmin e tij. Zakonisht puberteti vjen te vajzat me heret se te djemte. Prinderit mund te ndeshen me situata te reja veqanerishte kur rinin e tyre e kane perjetuar ne nje ambient reth tjetër. ndoshta prindërve ju kan fol për pubertetin ne menyre tjetër prej asaj që thuhet ne ditet e sotme e Finlandë .Ne pubertetet i riu zhvillohet, rritet fizikisht, në trupin e tij ka ndryshime dhe i ru bën krahasime me moshatarët e vet. Është më rëndesi që i riu te jete ne dije per ndryshimet qe ndodhin ne trupin e tij. Duhet te bisedoj me njerze te pjekur se cfare do te thote të bëhesh burrë apo grua. Ne shkolla mësohet edukata shëndetsore dhe seksuale, por edhe prindërit është udhes të bisedojnë për zhvillimin seksual me të riun. Nëse prindërit nuk mund ti përgjigjen pyetjeve të te riut, duhet të pyesin dhe te marrin keshilla te personeli mjeksor qe gjindet ne shkollë.

I riu e kërkon vetveten në shoqëri

Analizat e te riut për vetveten, se cfare njeriu është, cfare kërkon prej jetës i perkasin zhvillimit psikik te tij. I riu fillon të këtë botën dhe mendimet e tija , qe jo gjithmone deshiron të ju tregon prindërve. Te i riu sillen shumë mendime për vetveten , do të thotë se shume gjëra dëshirojne ti bëjn në mënyren e tyre dhe nuk ju besojne prindërve. Për prindërit është e vështirë të kuptojnë kokefortësin e te riut dhe veprimet e tyre, ku sipas mendimit te prindërve mund të jenë veprime të këqija. Është mirë që prindërit të bisedojne dhe ta ndegjojne te riun për gjërat që nuk i pranojn te i riu . I riu duke provuar në mënyren e vet përgatitet që ti marr përgjegjesitë për jetën e vet. Marrja e përgjegjësise për vetveten nuk bëhet për një ditë. Duke provuar, mësuar e gabuar i riu bëhet njeri i përgjegjshëm.

Ne pubertetet shoqrimi i te riut me moshatarët është i rëndesishëm. Me shoqeri kalon shumë kohë , duke biseduar dhe shkëmby mendime te ndryshme. I riu e krahason vetveten me shoket, moshatarët dhe me njerzit tjerë që e rrethojnë duke kerkuar rolin e tij si burrë apo grua. Duke e pas parasysh qe në kultura të ndryshme mund të këtë koncepte dhe mendime të ndryshme se cfare është roli burre apo grua, per te riun imigrante kjo ceshtje mund te jet pak e pa qarte dhe komplekse.

Është me rëndesi të veqantë që prindërit të bisedojnë dhe këshillojnë të rinjet për rritjen dhe pjekurin e tyre , si dhe te ju japin mundësi të rinjeve ti shprehin mendimet e tyre. I riu emigrant e kerkon vetveten, vendin e duhur ne boten e te rriturve. Kërkon vendin e duhur në mes të dy kulturave , të kultures finlandeze dhe të prindërve. Këtu rol te rëndesishëm luajnë prindërit si mësues për jetë.


Në moshen rinore duhët përkrahja e prindërve

I riu duke u rrite ka shume sfida përpara ,si vijimi në ciklin e lartë të shkollës njohja me shokë të ri,përcaktimi për studime dhe profesion,largimi nga shtëpia e prindërve,raportet dashurore.Për të rinjët meshkuj edhe sherbimi ushtarak ose civil.

Posaqërishte fëmijet në moshen e pubertetit që u është desht të shkeputen prej vendit të tyre, përveq gjërave tjera ju duhet të mësojne gjuhen e vendit. Në Finlandë te rinjet largohen prej shtëpisë se prindërit më herët se ne disa vendet tjera te botës. Të rinjëve në këtë periudhë të jetës ju duhet ndihma e prindërve edhe pse ata vet nuk e kërkojnë.

SI TA NDIHMOJMË TË RIUN TË RRIETET

- jepi urdher te qartë p.sh.për kohen.kur duhet te kthehet ne shtëpi, për mos përdurimin e drogave etj.
- trego,argumento cilat veprime janë të drejta dhe cilat jo.
- bisedo shpesh si është ,si kalon në shkollë dhe me shokë.
- bisedo ne lidhije me moshen e pubertetit. p.sh mundë të tregosh pervojat tuaja të rinisë
- ju duhet te jeni te njoftuar cfare është jeta e te rinjeve ne Finlandë
- bisedoni së bashku se cfarë mendon te bëjë kur te kryhet shkolla, cili profesion mund te jetë i përshtatshëm për të ardhmen.
- bisedo edhe me prinderit tjerë për rritjen e zhvillimin e te rinjëve në Finlandë.



8. EDUKIMI I FEMISË KËRKON PËRKUSHTIM- A MUNDEM ?

Nganjëherë është mirë me kërkua ndihmë prej të afërmive, shoqe ve, fqinjëve, shoqatave Me parë e cekem se emigrimi ndikon në familje. Ndrimet e mëdha shkaktojnë stresse dhe te marrin energji. Malli për kushërit dhe vendëllindjen te shkaktojnë lodhje dhe plogështi. Prinderit mund te ndihen te pa përkrahur dhe te vetmuar kur pergjegjesine edukative s munde ta ndajne me të tjerët.

Rutina e zakonshme, ritmi ditore të ndihmon p.sh.familja shkon me fjetë ne kohen e caktuar, koha e ushqimit është e njejt ,detyrat e fëmijeve në kohën e njejt .Kur anetarët e familjes mësohen në ritmin e zakonshëm .Kur jeta është e organizuar dhe situata konfliktuozë në familje ka më pak, të gjithë ndihen më mirë.

Më herët i kemi cek nevojat e fëmise për gjum. Të rriturve u nevojitet rreth 8 orë gjumë nate. Gjithashtu edhe fiskultura ndihmon që prinderit te ndihen më mirë. Eshtë mirë që cdo prindë te kene disa orë të lira për vetveten, së paku një herë në javë

Kur na duhet ndihmë jashtë shtëpisë, --prej shoqerisë

Utoriteteve institucionale. Shpesh bisedat me interes te njejte me te tjeret mund te ju ndihmojne. Ne lagjen ku banon me siguri ka kopshte per femije apo vendtakime per familje ku mund te shkosh per pak kohe apo ta lesh femijen.. Gjithashtu edhe shoqatat e juaja ne gjuhe amtare munden te organizojnë veprimtari për prindër dhe fëmijë. Kur jeni ne situatë të vështire kerkoni ndihmë prej autoriteteve për ceshtje sociale si p.sh. ndihmëse për punet e shtëpisë, punët për familje dhe fëmijë. Nëse jeni familje me shumë fëmijë apo me një prindë ndihmesa dhe përkrahja prej shoqerisë është shumë e dobishme.



Nganjëherë hallet,shqetesimet ,përvojat e kaluares ,pagjumesia ju ngarkojne mendjen,. Edhe oreksi për ushqim mund te ju humbas. Përqendrimi në punët e familjare ju behet me i veshtirë., e ardhmja mundë të ju duket e erret dhe pa shpresë,te gjitha punët e njerzit ju shkaktojne nervoza.Nëse keto ankesa dhe mendime ju zgjasin, do te ju pengojne ne kryrjen e punëve të përditëshme. Është e arsyeshme të kërkoni ndihmë të shërbimet mjeksore apo enti social.Duhet të thërrisni në telefonat e dedikuar për ndihmë .Mjeku mundë të ju ndihmoj me ilace për qetesim. Profesionalistet e tillë ju japin sherbime falas dhe kanë besushmëri të plotë në punën që e bëjnë. Në shumë qytete të Finlandës gjendën vendet për këshillim të emigranteve ku mundë të thirrni dhe te kërkoni keshillime për shumë gjëra.

Kerkesat dhe perkrahja e shoqerise

Shoqerin e Finlandes e quajne shoqeri te mireqenjes, me kete nenkuptojme kur shoqeria ofron sherbime falas, si sherbimet shendetsore,shkollimi per femijet sherbimet e kujdesit mental ,keshillimore per edukimin e femise .

Atyre qe nuk kane mundesi te shkojne ne pune shoqeria e mireqenjes ju ndihmon me te holla.Ne shume vende te botes sherbime te tilla ka pak dhe njerzit jane te detyrur te mbijetojne vete ose te kerkojne ndihme prej familjes apo kusherive. Shoqeria Finlandeze me sheebimet e ndryshme perkujdeset per cdo individ dhe familje dhe pret qe njerzit dhe familjet te kerkojne perkrahje e ndihme ne kohen e duhur.Si me lartë e cekem, ndihmë mundë të kërkohet prej autoriteteve të ndryshme.Nëse ndihma kerkohe me vonesë problemet rriten dhe bëhen me te vështira për tu zgjidhë.

Qellimi i kësaj fletushke është të ju ndimojë prindërve rreth edukimit te fëmisë ,që prinderit dhe femijët te kënaqen me familje në shoqerine e re.Nganjehere pa marre parasysht përpyekjet e prindërve për edukim ,problemeve s munde t ju ikim.

Prindërit që prej vendit te tyre nuk jane balafaquar me marrjen e këshillave prej profesionistëve për qeshtje familjare ,kështu që ngurrojnë të kerkojne keshilla dhe ndihmë prej të huajve. Disa mundë të kenë paragjykime apo përvoja të hidhura me autoritetet.Kontakti me zyrtaret duhet të mirret si rast i mire për me kërkun ndihmë dhë këshilla kur gjindenit në situatë të veshtirë. Kur prindërit janë te gatshem me bisedu dhe janë te hapur në shoqeri atëherë bashkpunimi i autoriteteve dhe ndihmesa e tyre mundë te jetë me frytedhanese.Mbyllja ne vetevte dhe refuzimii bashkpunimit krijone te zyrtarët paragjykime.Nese prindërit jane trajtuar keq prej zyrtareve eshte mire te jeni ne kontakte shoqatat e tuaja . Pyetni dhe kërkoni ndihmë te, autoritete të cilët i njohin të drejtat e klienteve.Me butësi dhe duke biseduar gjindet zgjidhija më e mirë.

9. KU TE KERKOHET NDIHME

Ne Finlande shume shoqata ,organizata ofrojne sherbime te ndryshme per familje.Nese jeni banore i ri ne kete shoqeri informatat mirret me veshtire.

Iformata ne gjuhe te ndryshme per sherbimet familjare gjenden ne adresen e internetit:

<http://www.infopankki.fi>

Ne kete faqe internet munde te informoheni me keto tema martes en,divorcin,problemet familjare,edukimin e femijeve dhe te rinjeve,

Problemet mentale,abuzimet dhe mvarshmerit(droga,duhani,alk oholi). Gjithashtu gjinden faqe te ndrushme te autoriteteve dhe organizatave qe munde te ju ndihmojne ne situata te veshtira ne jete.Edhe ne vendbanimi tuaj keni sherbimet sociale si dhe punetoret imigrante qe ju udhezojne.

Monika-Naiset liittto ry.eshte shoqate shume kulturore e femrave. Kjo shoqate ndihmon grate qe perjetojne dhune si dhe femijet e tyre..Shoqata ben kujdestari me telefon.ku jepet ndihme ne 16 gjuhe te ndryshme.

<http://www.monikanaiset.fi>

Informata per organizimin e shkollimeve per imigrante gjinden ne kete adrese interneti.

www.selma-net.fi

Informata per veprimtarin e Väestöliito Kotipuu dhe ndihmen qe ju ofron familjeve emigrante e gjeni në adresen e internetit.

www.vaestoliitto.fi >monikulttuurinen työ / Kotipuu

Väestöliito Kotipuu(asocacion per familjen) ju ndihmon famijleve imigrante per mireqenjen e tyre.Ne Kotipuu eshte e pasur me materiale te shumta lidhur me temat rapirtet njerzoren ne famlje,edukimi i femijeve etj.Kotipuu merret me veprimtari perkrahesese per adaptim te imigranteve dhe mirqenje ne familje. Puntoret e kotopuu(pema e shtepise) marrin pjese me ligjerata dhe bejne avokime per ceshtje te adaptimit te familjeve me kultura te tjera..Marrin pjese ne organizime te ndrushme dhe vende te punes.Perveq kesaj Kotipuu organizonper prinderit biseda ne grupe dhe jep keshilla permes telefonit familjeve ne situatete veshtire jetsore.



Kjo fletushkë për edukatën për bazë ka fletushkën në gjuhën somaleze e botuar më parë ,e shkruar prej Anne Alitolppa-Niitamo dhe Mohamed Moallin ,puntorë në Kotipui.Për këtë tekst dhanë komente edhe bashkëpuntorët Isuf Deda,Harun Osmani dhe Miranda Qerimi. Permbylljen dhe sygjërimet për tekstin i pershtati Jouni Sirkiä ,punëtor në Kotipuu.Tekstin e perktheu prej gjuhës finlandeze në gjuhën shqipe Miranda Qerimi.

VÄESTÖLIITÖN KOTIPUU FALENDERON NGROHTESISHTE ANETARET E GRUPIT PUNUES!

Kolektivi i Kotipuu pranon më kënaqësi komente për këtë material në adresën elektronike
kotipuu@vaestoliitto.fi

Teksti mund të gjindet në gjuhën finlandeze dhe në gjuhën shqipe në adresën elektronike:
www.vaestoliitto.fi >monikulttuurinen työ / Kotipuu>materiaalit

POROSIT

**Väestöliiton Kotipuu
PL 849,00101 Helsinki
Puh.(09) 228 0525
www.vaestoliitto.fi**